



457/2

29.12.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	29.12.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 457/2
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Pëlqim për renovim të Kino Lumbardhit

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8, 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren lëshon:

REKOMANDIM

Investitorit Kino Lumbardhi nga Prizreni, rruga / nr. / kërkohet që të kthehet lënda për plotësim të mëtejme të dokumentacionit, në ngastrën kadastrale nr. 02332-0 dhe 02332-0-30-0 K.K. Prizren me këto kushte:

- Ndërhyrjet në Kino Lumbardh nuk duhet të jenë ndërhyrje invazive që do të ndikojnë në cenimin e autenticitetit dhe vlerave të ndërtesës; Kjo për arsye se projekti i tërësishëm i konservimit dhe revitalizimit ende nuk është hartuar.

- Dera e vjetër në hyrje të korridorit të ruhet. Të vendoset një derë e përkohshme nga qelqi, sipas detajit të paraqitur në projekt. Dera nga qelqi të vendoset pranë derës së vjetër, me hapje në anën e kundërt;
- Në dysheme të hollit ku janë shtruar pllakat e vjetra qeramike, nuk lejohet vendosja e shtresës së parketit.
- Dyert e vjetra të nyjes sanitare ekzistuese të ruhen;
- Ndërhyrjet për rindërtim të nyjeve sanitare, në këtë moment nuk lejohen;
- Instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore të mos çënoj elementet e enterierit të ndërtesës, sikurse pllakat nga druri të vendosura në mure;
- Dritarja e cila do të largohet nga hapësira e Biletarisë, të ruhet në një vend të sigurt, në rast se vendoset më vonë që përsëri të përdoret.
- Ndërhyrjet në Bifen e Kinemasë nuk duhet të çënojnë elementet origjinale të enterierit; Elementet e lëvizshme sikurse banaku duhet të ruhen në një vend të sigurt; Dollapi / Rrafti i vendosur në mur nuk duhet të dëmtohet.

Pala duhet të sjell projekt detal me:

- Gjendjen ekzistuese të hapësirës ku planifikohet ndërhyrja;
- Projekti detal i ndërhyrjeve:
 - o Detaj i vendosjes së derës së qelqit në hyrje, bashkë me prezantimin e derës origjinale, e cila nuk duhet të largohet;
 - o Prezantimi i detalit të veshjes së mureve të Byfes, ku pllakat duhet të ruhen dhe të mos dëmtohen nga ndërhyrja e re;
 - o Prezantimi i detalit të adaptimit të rafteve në dollape;
 - o Paraqitja e instalimeve të ngrohjes në plan të përdhësës;
 - o Paraqitja e instalimeve elektrike në plan të përdhësës;
 - o Paraqitja e instalimeve të ujësjellësit në plan të përdhësës;

A r s y e t i m

Kërkesa e parashtruar nga investitori për renovim të kulmit nga dispozicioni i këtij pëlqimi gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit. Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, QRTK ka shqyrtuar lëndën në fjalë.

Kino Lumbardhi gjendet në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përkohshme 2017-2018, me numër unik 4131. Ndërhyrjet e paraqitura në kërkesë parashohim renovimin e

korridorit në hyrje të sallës (shtrimi i dyshemesë me parket, dhe instalimi i sitemit të ngrohjes), adaptimin e biletarisë në hyfë, trajtimi dhe renovimi i nyjeve sanitare, adaptimin e bufesë në hapësirë të punës.

Pasi që projekti i konservimit dhe revitalizimit të Kino Lumbardhit është në hartim e sipërm, ndërhyrjet me qëllim renovimi duhet të jenë minimale në mënyrë që mos të çënojnë vlerat e ndërtesës.

Pas shqyrtimit të Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore, është vlerësuar se lënda duhet të kthehet për plotësim të mëtejme të dokumentacionit.